



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

KKDM/Nr. ....**74**..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 28 / 06 / 2024

**VENDIM**

Nr. 15 datë 28 / 06 / 2024

**PËR**  
**PROJEKT ZBATIMIN E RISHIKUAR TË OBJEKTIT**  
**“RIKONSTRUKSIONI I NYJES HIDROTEKNIKE TË MANSKURISË”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 ”Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave” dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 ”Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 28.06.2024 mori në shqyrtim Projekt Zbatimin e rishikuar të paraqitur nga UK Durrës për Rikonstruktionin e nyjes hidroteknicë të Manskurisë ku përfshihet edhe diga e Manskurisë me lartësi H=36 m e ndërtuar në vitin 1969 dhe e dëmtuar në vitin 2015 si rezultat e carjes së tubacionit të marrjes së ujit dhe krijimit të zgavrave në trupin e digës.

Projekt zbatimi është prezentuar nga firma konsulente Zenit&CO shpk. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se firma konsulente ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në legjislatacionin e mësipërm. Përfaqësuesit e firmës Konsulente ishin prezent në mbledhje dhe dhanë sqarimet përkatëse në lidhje me masat e parashikuara për rikonstruktionin e kësaj digë. Duke qenë se kjo digë klasifikohet si digë me rrezik të lartë për shkak të numrit të njerëzve në rrezik që ndodhen në zonën urbane poshtë saj, në diskutimet e organizuara gjatë takimit, antarët e KKDM e përqëndruan vëmendjen në plotësimin e kërkesave të Vendimit të KKDM Nr.05, datë 21.02.2024 sidomos në lidhje me llogaritjet për verifikimin e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit të digës para dhe pas rikonstruktionit duke marrë në konsideratë vlerat e rrezikut sizmik të kërkuara në Vendimin e KKDM Nr. 15, datë 15.02.2021 si dhe kontrollin e kapaciteteve të sistemit të shkarkimit të kërkuara në Vendimin e KKDM Nr. 36, datë 25.10.2023. Përfaqësuesit e Konsulentit konfirmuan se llogaritjet e qëndrueshmërisë së digës janë realizuar në përputhje me vlerat e rrezikut sizmik tek hartat e rrezikut sizmik dhe në termat e nxitimit maksimal të dhëna nga IGJEQ si dhe koeficientët e sigurisë së digës si digë me rrezik të lartë të kërkuara në Vendimin e mësipërm të KKDM. Gjithashtu, Konsulenti konfirmoi edhe kontrollin e kapacitetit të sistemit të shkarkimit për prurjet një herë në 1000 vjet. Antarët e KKDM vunë në dukje faktin e mungesës së sistemit të alarmit në digë dhe sistemeve të monitorimit të digës gjatë rikonstruktionit dhe gjatë shfrytëzimit të saj, sipas kërkesave të legjislatacionit në fuqi, duke kërkuar që këto sisteme të parashikohen me përparësi në projekt.

Këshilli Teknik i Përherëshëm i Digave (KTPD) dhe SKDM i rekomandoi antarëve të KKDM të kërkojnë plotësimin e disa kërkesave teknike të shprehura nga Oponanca e IN si dhe plotësimin me detaje të disa elementeve kryesorë si detajet në lidhje me vëndosjen e veprës së marrjes së ujit, detaje të lidhjes së trupit ekzistues të digës me pjesën e re, etj. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM:

**VENDOSI:**

1- Ti kërkoj UKD si shfrytëzuese e digës së Manskurisë të bëj plotësimet e mangesive të konstatuara nga KTPD, KKDM dhe Oponanca e IN në projektin e zbatimit të paraqitur, konkretisht:

- Projekti duhet të plotësohet me sistemin e alarmit që duhet të vendoset në digë dhe në zonën urbane poshtë saj për shkak të rriskut të lartë që është evidentuar gjatë hartimit të projektit ku mëse 2000 persona janë në rrezik në rast të prishjes së digës;
- Projekti duhet të plotësohet me planin e monitorimit të digës gjatë rehabilitimit, mbushjes së rezervuarit për herë të parë pas përfundimit të punimeve si dhe gjatë shfrytëzimit të



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

digës për të paktën 10 vitet e para pas përfundimit të këtyre punimeve të rehabilitimit. Sistemi i monitorimit të digës duhet të plotësohet me një sistem të monitorimit gjeodezik për pjesën e re dhe pjesën ekzistuese të trupit të digës duke vodusur monumentet e duhura në të dy zonat sipas kërkesave të KKDM dhe rekondimeve të ICOLD. Gjithashtu, sistemi i monitorimit duhet të plotësohet me një sistem të monitorimit me fibrat optike në pjesën e poshtme të digës, sistem të piezometrave automatike në pjesën e re të trupit të digës si dhe me një sistem të plotë të monitorimit sizmik me të paktën dy akseleratorë në trupin e digës. Projekti i zbatimit duhet të japë në detaje pjesët përbërëse të cdo sistemi të monitorimit të digës që do të parashikohen përfazën e ndërtimit dhe të shfrytëzimit;

- Projekti duhet të plotësohet me paraqitjen e kurbës së depresionit të llogaritur dhe përcaktuar nga Projektuesi në të paktën dy prerje tërthore në pjesën e re dhe dy prerje tërthore në pjesën ekzistuese të trupit të digës;
- Projekti duhet të detajohet dhe të qartësohet në lidhje me pjerrësinë e skrapatës në pjesën e sipërme dhe të poshtme të anës së poshtme të trupit të digës në bazë të llogaritjeve të kryera për qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e digës pas rehabilitimit të saj duke dhënë edhe elementet kryesore të këtyre, skrapatë (gjatësinë, pjerrësinë, veshjen e skrapatës, etj);
- Projekti duhet të plotësohet me detaje tek vizatimet dhe metodologja e punës përlidhjen e pjesës së re me pjesën ekzistuese të trupit të digës duke dhënë edhe treguesit kryesorë gjetecknike të shtresave që do të vendosen në zonën e rehabilitimit;
- Projekti duhet të plotësohet me detajet për veprën e marrjes dhe bazamentin ku do të vendoset kulla e marrjes së ujit. Projekti duhet të paraqesë detajet dhe llogaritjet përkatëse konstruktive për portat e kullës së veprës së marrjes dhe për strukturen metalike të urës si dhe formacionet e bazamentit ku do të vendosen këmbet e urës dhe vepra e marrjes së ujit;
- Projekti duhet të plotësohet me vlerësimin e Projektuesit në lidhje me efektivitetin dhe domosdoshmërinë e këtij investimi duke përfshirë edhe jetëgjatësinë e objektit pas rehabilitimit si dhe kostot e prodhimit të ujit, sipas kërkesave të KKDM të shprehur në Vendimin e mëparshëm.

**2- Ti kërkoj Shoqërise Rajonale të UK Durrës dhe Investitorit**

- Të plotësoj dokumentacionin teknik të projektit sipas kërkesave të mësipërme përparrë fillimit të punimeve të rikonstrukzionit të digës së Manskurisë dhe të informoj KKDM për plotësimin e këtyre kërkesave;
- Të zbrazë rezervuarin e krijuar nga kjo digë para fillimit të punimeve
- Të njoftoj KKDM në lidhje me Mbikqyrjen e punimeve duke patur në konsideratë kërkesat e Nenit 20,21,24 dhe 27 të VKM Nr.147, datë 18.03.2004. UKD të caktoj një përfaqësues të saj për ndjekjen e cilësisë së punimeve dhe sistemet e monitorimit gjatë zbatimit të punimeve

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkua të këtë vendim sipas legjispcionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**  
**Arjan JOVANI**